



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data:	18.05.2023
Numër:	07/ zyrt
Për:	Kryesuesen e Kuvendit Komunal të Komunës së Gjakovës, Znj Arbëresha Kuqi.
Nga:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Arben Bakalli –Drejtör i Drejtorisë.
Lënda:	Informatë

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Gjakovë, në shërbim të kërkesës së datës 12.05.2023, të parashtruar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) nga Znj. Mimoza Shala, ku përmes të cilës është kërkuar që për mbledhjen e radhës të Kuvendit, nga DUMM të prezantohet një raport lidhur me lejet e ndërtimit për periudhën një vjeçare, duke përfshirë sa leje janë dhënë për këtë periudhë, sa leje janë dhënë pasi kanë filluar ndërtimet, dhe për sa kërkesa nuk janë dhënë lejet e ndërtimit dhe pse janë bërë kërkesat.

Në shërbim të kërkesës së parashtruar, ka bërë analizimin e të gjitha lejeve të trajtuara për periudhën 1 (një) vjeçare nga DUMM dhe, pas verifikimit dhe analizimit të lejeve të lëshuara për këtë periudhë ju informon si në vijim:

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2022 janë lëshuar gjithsej 109 leje ndërtimore dhe nga to:

- 60 leje ndërtimore për kategorinë e parë (objekte me rrezikshmëri të ultë), me sipërfaqe totale të trajtuar për ndërtim $S=5015.87 m^2$.
- 31 leje ndërtimore për kategorinë e dytë (objekte me rrezikshmëri të mesme) me sipërfaqe totale të trajtuar për ndërtim $S=144.455.97 m^2$.
- 18 leje të institucioneve arsimore, fetare dhe panele solare.

Gjatë periudhës janar – maj 2023, gjer më tani janë lëshuar gjithsej 52 leje ndërtimore dhe nga to:

- 25 leje ndërtimore për kategorinë e parë (objekte me rrezikshmëri të ultë), me sipërfaqe totale të trajtuar për ndërtim $S=9695.1 m^2$.
- 21 leje ndërtimore për kategorinë e dytë (objekte me rrezikshmëri të mesme) me sipërfaqe totale të trajtuar për ndërtim $S=73.511.8 m^2$.
- 7 leje të institucioneve arsimore, fetare dhe panele solare.

DUMM-Gjakovë, për sa i përket pyetjes së parashtruar se sa leje janë dhënë pasi kanë filluar ndërtimet, meqenëse pyetja nuk ka qenë e specifikuar në mënyrë të qartë, ju informojmë se bazuar në legjislacionin në fuqi, dhënia e lejeve ndërtimore përpos tjerash është paraparë, pra është e mundur të lëshohet sipas kërkesave të investitorëve dhe sipas principit të ndarjes nëpër faza, për shkak të pamundësisë së pagesës në tërësi apo dhe për shkak të tjera, ku gjatë kësaj periudhe disa blloqe banesore janë trajtuar sipas këtij principii.

DUMM-Gjakovë, për sa i përket pyetjes së parashtuar se për sa kërkesa nuk janë dhënë lejet e ndërtimit dhe pse janë bërë kërkesat, ju informojmë se për vitin 2022 (periudha janar – dhjetor) gjithsej janë refuzuar 20 kërkesa për kushte si dhe për leje ndërtimore, ndërsa për vitin 2023 (periudha janar – maj) janë refuzuar gjithsej 25 kërkesa për kushte si dhe për leje ndërtimore, të cilat kanë qenë të natyrave të ndryshme, kryesisht kërkesa për tejkallim ose në kundërshtim me dokumentet hapësinore në fuqi, .

Për çdo sqarim shtesë rreth kësaj jemi në dispozicionin tuaj

Faleminderit për mirëkuptim.

Me respekt!



KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA PËR URBANIZIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Postal address: Nëna Tereze nr.181 Gjakovë,

Tel: +381 390 322-452, 320-070, 325-059

www.gjakova-komuna.org